

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Civil, me gjyqtarin Enes Mehmeti dhe bashkëpunëtorin profesional Driton Ahmeti, në çështjen e inicuar me padinë e paditëses [REDAKTUAR] nga Ferizaj Rr. [REDAKTUAR] nr. [REDAKTUAR] të cilën me autorizim e përfaqëson [REDAKTUAR] zyrtar ligjor i Sindikatës së Shëndetësisë për regjionin e Ferizajit, kundër të paditurës Spitali Rajonal në Ferizja, në çështjen juridike pagesë e pagave përcjellëse dhe jubilarë, duke vendosur jasht seancë, me datë 20.09.2018 merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET, në tërësi kërkesëpadia e paditësit [REDAKTUAR] nga Ferizaj Rr. [REDAKTUAR] nr. [REDAKTUAR] si e bazuar.

II. DETYROHET, e paditura Komuna e Ferizaj- Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare Ferizaj, që paditësit në emër të tri pagave përcjellëse me rastin e pensionimit në lartësi prej 1.348.29 €, dhe tri pagave jubilarë në lartësi prej 1.348.29 €, e që shuma e përgjithshme i bie **2.696.58 € (dy mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e gjashtë euro e pesëdhjetë e tetë cent)**, të cilën shumë e paditura është obliguar t'ia paguaj paditësit, së bashku me kamatën ligjore në lartësi prej 8%, duke filluar nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 40.00 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

A r s y e t i m i

Paditësja përmes përfaqësuesit të saj, me datë 23.07.2018 ka parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Ferizaj- Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare Ferizaj, lidhur me pagesën e tri pagave përcjellëse me rastin e pensionimit dhe pagesën e tri pagave jubilarë. Paditësja ka qenë në marrëdhënje pune të paditura, në vendin e punës si infermiere në Spitalin Rajonal në Ferizaj, deri me datë 14.05.2018, ku sipas fuqisë ligjore iu është ndërprerë marrëdhënia e punës për shkak të arritjes së moshës të pensionimit. Pas marrjes së vendimit për pensionim, paditësja ju është drejtuar të paditurës si ish pundhënëse me kërkesë që t'ia paguaj një pagë jubilarë për punën mbi 40 vite e të cilat kërkesa këto janë të parapara me nenin 52 dhe 53 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës dhe kompensimin e pagesës përcjellëse në vlerë të tri pagave në tre muajt e fundit, e cila kërkesë është refuzuar si e pa bazuar.

Gjykata, pasi që ka shqyrtuar shkresat e lëndës, me aktvendimin C.nr.693/18, datë 16.08.2018, të marr në bazë të nenit 394 të LPK-së, gjykata e ka obliguar të paditurën që në afat prej 15 ditësh nga dorëzimi i padisë me të gjitha provat materiale, të paraqes përgjigje në padi në formë të shkruar në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palën paditëse, nën kërcënim të pasojave procedurale. E paditura në përgjigjen e saj në padi të datës 30.08.2018, e ka kundërshtuar

kërkespadinë duke theksuar se Ministria e Shëndetësisë dhe Federata e Sindikatave të Shëndetësisë në muajin Mars 2015 (tani e ripërtirë në qershor të 2018) e cila i obligon Institucionet Shëndetësore që të zbatojn këtë, po që paraprakisht me rastin e aprovimit të Buxhetit të Kosovës për këtë sektor të sigurohen mjete financiare, prandaj Spitali Rajonal pasi që është shfrytëzuese e këtij buxheti , mjetet buxhetore mund të shfrytëzohen vetëm për destinime që i janë dhënë, nuk mundë të ridestinohen, shfrytëzimi i të cilave bëhet nën mbikqyrjen rigoroze të Ministris së Financave. Ndërsa sa i përket pagave jubilarë, si vit jubilar llogaritet viti 2013 kur i ka bërë 40 vite përvoj pune, dhe pasi nuk ka kërkuar pagën jubilarë sipas nenit 52 paragrafi 3 i Marrëveshjes së Përgjithëshme Kolektive të Kosovës, atëher kemi parashkrim të lëndës sipas nenit 87 të Ligjit të punës.

Gjykata duke i vlerësuar provat një nga një dhe të gjitha së bashku në kuptim të nenit 8 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Gjykata ka vërtetuar gjendjen faktike, se nuk është kontestuese në mesë palëve se paditësja për shkak të arritjes së moshës 65 vjeçare ka shkuar në pension, e paditura nuk e ka kontestuar pretendimet në padi nga ana e paditëses se ka përvojën e punës mbi 40 vjet.

Gjykata me rastin e përcaktimit të lartësisë për tri pagave përcjellëse shumë prej 1.348.29 € dhe tri pagave jubilarë në shumë prej 1.348.29 €, është bazuar në bilanci I llogaris bankare të paditëses e datës 20.06.2018 të lëshuar nga e Pro credit Bank, të cilën në gjykatë e ka dorëzuar e paditësja, nga ku vërtetohet se paditësja në muajt e fundit para daljes në pension dhe atë në muajin mars, prill dhe maj ka pranuar pagën mujore 449. 29€.

Gjykata me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë është bazuar në faktin se me kontratën kolektive të nënshkruar nga Qeveria e Kosovës, për punëmarrësin Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës e cila është nënshkruar nga ana e dy palëve dhe në neni 82 të kësaj kontrate përcaktohet se kjo kontratë hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga palët ndërsa zbatohet prej 01 Janar të viti 2015.

Në pjesën hyrëse respektivisht në nenin 2 të Marrëveshjes së Përgjithëshme Kolektive të Kosovës, është e përcaktuar qartë se kush përfiton nga kontrata kolektive e që në rastin konkret paditësi e ka shfrytëzuar një të drejtë pasi që i njëjti përfiton nga kjo kontratë për faktin se me rastin e daljes së tij në pension kontrata kolektive ka qenë në fuqi e cila nuk është kontestuar nga ana e të paditurës.

Në nenin 52 par. 1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të Marrëveshjes së Përgjithëshme Kolektive të Kosovës është përcaktuar që punëtori ka të drejtë në shpërblim jubilar për 10 vite të përvojës në punë te punëdhënësi i fundit në vlerë të një page bazë, për 20 vite të përvojës në punë te punëdhënësi i fundit në vlerë prej dy pagave bazë dhe për 30 vite të përvojës së punës te punëdhënësi i fundit në vlerë prej tri pagave bazë, punëdhënësi i fundit është ai që e paguan shpërblimin jubilar, se shpërblimi jubilar paguhet në afat prej 1 muaji pas plotësimit të kushteve nga kjo pikë, çka do të thotë se e paditura është dashur që me rastin e daljes në pension paditësit brenda 1 muaji sipas nenit 52 par.2 dhe 3 t'ia paguajë një paga jubilarë pasi që i ka plotësuar këto

kushte, pasi ka pasur përvojën e punës mbi 10 vjeçare dhe ka qenë obligim i të paditurës që të bëjë pagesën pa pasur nevojë as për të paraqitur ndonjë kërkesë qoftë gojore apo me shkrim të paditurës.

Kurse neni 53 të Marrëveshjes së Përgjithëshme Kolektive të Kosovës, është përcaktuar se punëtori ka të drejtë që me rastin e pensionimit në pagesat përcjellëse në lartësi të tri pagave sipas mesatares së tri pagave të fundit të punëtorit, e në rastin konkret Gjykata ka marr parasysh që tri pagat e fundit të punëmarrësit nuk kanë qenë të ndryshuara të cilat ishin në lartësi prej 449.00 €.

Gjykata lidhur me pretendimet e të autorizuarit të paditurës se kërkesa për kompenzimin e pagave përcjellëse dhe jubilarë është paraqitur pas afatit dhe se bazuar në nenin 90 par 4 të Ligjit të Punës Ligjit të Punës Nr.03/1/L-212 i Republikës së Kosovës i cili përcakton se Marrëveshjet Kolektive mund të lidhen për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet, nuk qëndrojnë sepse bazuar në nenin 81 të Marrëveshjes së Përgjithëshme Kolektive të Kosovës, parashihet se pasi që i skadon afati i përcaktuar, nuk tërhiqet asnjëra pale, zbatimi i saj vazhdon edhe për një vitë.

Kurse sa i përket asaj që pagat jubilarë janë të parashkruara pasi që në nenin 52 par.3 pikal.1, 1.2, 1.3, kjo bëhet brenda një muaji për çdo 10 vite, ku paditësja ka bërë dhe në atë kohë është dashur të realizohen këto të drejta.

Gjykata konsideron se një pretendim i tillë është i pa bazuar se në rastin konkret nuk kemi parashkrim, pasi që sipas nenit 52 par.3 pikal.1, 1.2, 1.3, thuhet qartë se për të përfituar paga jubilarë antarët e FSSHK-së, në rastin konkret paditësja duhet që fillimisht të dali në pension që të përfitojë shpërblimin jubilar e jo në kohën sa është në marrëdhënie pune, respektivisht kur i ka bërë 10 vite përvojë pune, 20 apo 30, siç parashihet me këtë nen.

Nga sa u tha më sipër, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi bazur në nenin 152 të LPK-së, lidhur me nenin 52, 53 dhe 81 par 1 të Marrëveshjes së Përgjithëshme Kolektive të Kosovës dhe nenit 87 të Ligjit nr.03/L-2012 të Punës në Kosovë.

Për shpenzimet e procedurës, gjykata ka vendosur në bazë të nenit 452 par 1 të LPK-së.

REPUBLIKA E KOSOVËS  **GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**
REPUBLIKA KOSOVA **C.m.693/18 datë 20.09.2018**

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ II UROŠEVAC

Më 22 SEPTEMBER 2019
Dana

KËSHILLA JURIDIKE Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankese në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të kopjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.



GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Civil, me gjyqtarin Enes Mehmeti dhe bashkëpunëtorin profesional Driton Ahmeti, në çështjen e inicuar me padinë e paditëses [REDACTED] nga Ferizaj Rr. [REDACTED] nr. [REDACTED] të cilën me autorizim e përfaqëson [REDACTED] zyrtar ligjor i Sindikatës së Shëndetësisë për regjionin e Ferizajit, kundër të paditurës Spitali Rajonal në Ferizja, në çështjen juridike pagesë e pagave përcjellëse dhe jubilarë, duke vendosur jasht seancë, me datë 19.11.2018 merr këtë:

AKTVENDIM

Bëhet përmisimi i Aktgjykimi të kësaj Gjykate me numër C.nr.693/18 i datës 20.09.2018, vetëm sa i përket të paditurës, ashtu që në vend të paditurës "Komuna e Ferizaj- Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare Ferizaj" zëvendësohet me të paditurën "Spitali Rajonal në Ferizja", pjesa tjetër e Aktgjykimit mbetet e pandryshuar.

Arsyetim

Gjykata pas dorëzimit të këtij Aktgjykimi palëve ndërgjyçëse, ka hasur se në Aktgjykimi me numër C.nr.693/18 i datës 20.09.2018, është përvjelur gabimi i natyrës teknike ashtu që në vend të palës së paditurës të këtij Aktgjykimi "Komuna e Ferizaj- Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare Ferizaj" zëvendësohet me të paditurën "Spitali Rajonal në Ferizja". Për këtë gabim gjykata është njoftuar me kërkesën e palës e cila është dorëzuar në këtë gjykatë me datën 18.10.2018, e cila me anë të kërkesës kërkon nga gjykata të bëjë përmirësimin e palës së paditurës të këtij Aktgjykimi, prandaj gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Andaj gjykata bazuar në nenin 165 të LPK-së, ka vendosur si në Dispozitiv të këtij Aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

REPUBLIKA E KOSOVËS



REPUBLIKA E KOSOVËS

C.nr.693/18, me datën 19.11.2018

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ II UROŠEVAC

Më
Dana

22 21 20 19

KËSHILLA JURIDIKE Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankësata në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktvendimi, Gjyates së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.



Gjyqtari

Enes Mehmeti